

IKAF F4 Ligji i Korporatave dhe Biznesit

Syllabus dhe Udhëzues Studimi

*Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

Struktura e Kualifikimit

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Kontabilist i Certifikuar në të cilën bënë pjesë edhe moduli Ligji i Korporatave dhe Biznesit. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

Moduli

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

Struktura e Syllabusit

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Ligji i Korporatave dhe Biznesit i cili është pjesë e nivelit Kontabilist i Certifikuar. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

Udhëzuesi i Studimit

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuara në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.


STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

*Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Planprogrami për kualifikim për Kontabilist të Çertifikuar siguron një theks të veçantë në aftësitë e raportimit financiar të cilat janë zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kontabilistët e Çertifikuar do të mësojnë parimet dhe sistemet e kontrollit të brendshëm për ndërmarrjet, metodat e auditimit dhe standardet si dhe një grup të gjerë të planifikimit të biznesit, mbështetjen e vendimeve dhe aftësitë e menaxhimit të performancës.

Për t'u trajnuar për Kontabilist të Çertifikuar ju duhet së pari të përfundoni kualifikimin për Teknik të Kontabilitetit. Anëtarësia për Kontabilist të Çertifikuar është e hapur për profesionistët të cilët punojnë në kontabilitet e të cilët kanë përfunduar kualifikimin e IKAF për Teknik të Kontabilitetit.


Kandidatët në Kualifikimin për Kontabilist të Certifikuar duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulën "Ligji i Korporatave dhe Biznesit".



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve dhe certifikimeve deri tek titulli Kontabilist i Certifikuar

Modulet

Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar përmbanë gjithsej pesë module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Kualifikimit Kontabilist i Certifikuar

Kriteret e kualifikimit dhe anetaresimit: Kontabilist të Certifikuar

- Diplomë Universitare;
- Përfundimin e nivelit për Teknik të Kontabilitetit;
- Dëshmi për së paku tre (3) vite përvojë pune të verifikuar në kontabilitet - që mund të përfitohet edhe gjatë apo pas trajnimit.
- Të kenë vijuar dhe kaluar pesë (5) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nese arrihet 50% e pikeve ne test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “Kontabilist të Çertifikuar” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt ne IKAF për ta përdor titullin “Kontabilist të Çertifikuar” e kane obligative ndjekjen e edukimit te vazhdueshem professional (EVP/CPD) te percaktuara edhe ne rregullore te IKAF-it.

Karakteristikat e ligjërates trajnuese:

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve; dhe gjatë ligjërates, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushen e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trjanues është i bazuar në planëprogramet ACCA.
- Në përfundim të kësaj ligjërates, studentet do të jenë te gatshëm ti nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

STRUKTURA E SYLLABUSIT

Arsyetimi

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

Diagrami i relacioneve mes moduleve

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

Qëllimi

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modulit.

Aftësitë kryesore

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

Temat

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

Struktura e Ekzaminimit

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi.

Shtojcë Syllabusi i Detajuar

Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

MODULI

Ky syllabus dhe manual studimi është krijuar për të ndihmuar në planifikimin e studimeve dhe sigurimin e informacioneve më të detajuara mbi atë që mund të jetë pjesë e testimit vlerësues.

Arsyetimi

Planprogrami i modulit Ligji i Korporatave dhe Biznesit, ka lidhje të drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis moduleve të tjera dhe moduleve të mëparshme. Disa module janë të mbështetura drejtpërdrejt nga modulet e tjera dhe të tjerat kanë vetëm lidhje indirekte me njëra-tjetrën, siç janë lidhjet ekzistuese midis moduleve të kontabilitetit dhe auditimit.



Diagrami.3.: Ndërlidhja e moduleve

Ligji i Korporatave dhe Biznesit është i ndarë në tetë zona. Syllabusi fillon me një hyrje në sistemin e përgjithshëm ligjor të Kosovës, të tilla si sistemi gjyqësor dhe burimet e ligjit. Ajo pastaj çon në fushën e detyrimeve ligjore, duke përfshirë kontratën dhe tort, të cilat mbështesin transaksionet e biznesit në përgjithësi. Syllabusi pastaj mbulon një varg fushash të caktuara ligjore që lidhen me aspekte të ndryshme të biznesit, me të cilat brengosemi për financimin e profesionistëve. Seksioni përfundimtar lidhet me të gjitha fushat e mëparshme. Kjo pjesë trajton sjelljet mashtruese dhe kriminale të korporatave.

Qëllimi

Zhvillimi i njohurive dhe kuptimi i parimeve dhe koncepteve të përgjithshme të kornizës ligjore dhe fushave të caktuara në lidhje me biznesin, duke njohur nevojën për të kërkuar këshilla të mëtejme profesionale.

Aftësitë kryesore

- Identifikimi i elementeve thelbësore të sistemit ligjor, duke përfshirë edhe burimet kryesore të ligjit
- Njohja dhe zbatimi i rregullave të duhura ligjore në marrënie me detyrimet
- Shpejgimi dhe zbatimi i ligjit në lidhje me marrëdhëniet e punes
- Njohja e mënyrës së themelimit të shoqërive tregtare dhe ligjet për shoqëritë tregtare
- Njohja dhe krahasimi i llojeve të kapitalit dhe themelimin e kompanive
- Njohja dhe shpjegimi se si menaxhohen dhe administrohen kompanitë

- Njohja e implikimeve ligjore në lidhje me paaftësinë paguese të kompanive
- Njohja e rregullave për klasifikimin e shoqërive tregtare dhe raportimin financiar
- Shkeljet ligjore penale të personave juridik dhe personave zyrtarë

Temat

Temat kryesore të Modulit Ligji i Korporatave dhe Biznesit që do të trajtohen gjatë ligjërates:

Sistemi Juridik - Elementet Themelore
Marrëdhëniet e Detyrimeve
E Drejta e Punës
Themelimi dhe Statusi i Shoqërive Tregtare
Bashkimi Dhe Ndarja e Korporatave
Pronësia Intelektuale dhe Parteneriteti PP
Paaftësia Paguese e Shoqërive Tregtare (Falimentimi)
Klasifikimi i Shoqërive Tregtare dhe Raportimi Financiar
Shkelje Ligjore Penale të Personave Juridik

Diagrami.4.: Temat që do të trajtohen në Modulin Ligji i Korporatave dhe Biznesit

Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 3 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të cdo provimi tre orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

Shtojcë: Syllabusi i Detajuar

Syllabusi i Detajuar

A PJESA "A" - SISTEMI JURIDIK – ELEMENTET THEMELORE

- a) Rregullimi shtetëror kushtetues
- b) Burimet e së drejtës, Ligjet dhe fuqia juridike
- c) Sistemi gjyqësor
- d) Zgjidhja jashtë gjyqësore e kontesteve ekonomike
- e) Të drejtat e njeriut

B PJESA "B" - MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

- a) E drejta e detyrimeve
- b) Parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve
- c) Lidhja e kontratave
- d) Kushtet për krijimin e detyrimeve
- e) Llojet e kontratave
- f) Mospërbushja (shkelja) e kontratave
- g) Mjetet për mbrojtje juridike të detyrimeve
- h) Përfaqësimi dhe pakujdesia profesionale

C PJESA "C"- E DREJTA E PUNËS

- a) Marrëdhëniet e punës
- b) Kontrata e punës
- c) Ndërprerja e marrëdhënies së punës
- d) Organizatat e të punësuarve
- e) Siguria dhe shëndeti në punë

D PJESA "D"- Shoqëritë Tregtare

- a) Ligjet për shoqëritë tregtare
- b) Regjistrimi i bizneseve
- c) Biznesi Individual
- d) Ortakëria e Përgjithshme
- e) Ortakëria e Kufizuar
- f) Shoqëria aksionare

E Bashkimi dhe Ndarja e Korporatave

- a) Bashkimi dhe Ndarja e Korporatave
- b) Bashkimet Ndërkufitare të Korporatave

F Pronësia Intelektuale dhe Partneriteti PP

- a) Pronësia Intelektuale
- b) Partneriteti Publiko Privat

G Paaftësia Paguese e Shoqërive tregtare Falimentimi

- a) Falimentimi i Shoqërive Tregtare
- b) Procedura Gjyqësore e Likuidimit

H Raportimi financiar i shoqërive tregtare

- a) Raportimi Financiar i Shoqërive Tregtare

I PJESA "J" – SHKELJET LIGJORE PENALE TË PERSONAVE JURIDIK

- a) Përgjegjësia penale
- b) Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal
- c) Korrupsioni dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Manual Studimi

PJESA - A - SISTEMI JURIDIK – ELEMENTET THEMELORE

1. Rregullimi shtetëror kushtetues
2. Burimet e së drejtës, Ligjet dhe fuqia juridike
3. Sistemi gjyqësor
4. Zgjidhja jashtë gjyqësore e kontesteve ekonomike
5. Të drejtat e njeriut

A1 Rregullimi shtetëror kushtetues

1. Sistemi juridik;
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
3. Shteti- Republika e Kosovës;
4. Qeverisja dhe ndarja e pushtetit;
5. Marrëdhëniet ekonomike.

A2 Burimet e të drejtës – ligjet dhe fuqia juridike

1. Hyrje - ligjet;
2. Burimet e së drejtës;
3. Hierarkia e akteve ligjore;
4. Ligjet - përkufizimi;
5. E drejta civile - ligjet e të drejtës civile;
6. E drejta penale - ligjet e të drejtës penale.

A3 Sistemi gjyqësor

1. Pushteti gjyqësor;
2. Organizimi dhe kompetencat e gjykatave;
3. Gjykata themelore;
4. Gjykata e apelit;
5. Gjykata supreme.

A4 Zgjidhja jashtë gjyqësore e kontesteve ekonomike

1. Hyrje;
2. Arbitrazhi;
3. Procedurat e arbitrazhit;
4. Procedurat gjyqësore lidhur me vendimet e arbitrazhit;
5. Ndërmjetësimi.

A5 Të drejtat e njeriut

1. Të drejtat dhe liritë e njeriut;
2. Marrëveshjet dhe instrumentet e të drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;
3. Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut;
4. Të drejtat e njeriut sipas Kushtetutës së Kosovës.

PJESA – B” MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

1. Të drejtat dhe liritë e njeriut
2. Marrëveshjet dhe instrumentet e të drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut
3. Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut
4. Të drejtat e njeriut sipas Kushtetutës së Kosovës

B1 – E drejta e detyrimeve

1. E drejta e detyrimeve;
2. Burimet e të drejtës së detyrimeve;
3. Krijimi i detyrimeve;
4. Efektet ligjore të detyrimeve.

B2 – Parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve

1. Parimet e përgjithshme në marrëdhëniet e detyrimeve;
2. Rregullat e përgjithshme në marrëdhëniet e detyrimeve;

B3 - Lidhja e kontratave

1. Kontratat;
2. Lidhja e kontratave;
3. Oferta për lidhjen e kontratës;
4. Pranimi i ofertës;
5. Dallimi ndërmjet ofertës dhe informatave;
6. Ftesa për ofertë;
7. Parakontrata.

B4 – Kushtet për krijimin e detyrimit (lidhjes së kontratës)

I. Kushtet e përgjithshme

1. Pajtimi i vullnetit të palëve;
2. Objekti i detyrimit kontraktues;
3. Baza e lejueshme;
4. Aftësia (zotësia për të vepruar);
5. Të metat e vullnetit;
6. Forma e kontratës;
7. Kushti;
8. Afatet;
9. Kapari dhe pendesa.

II. Kushtet e veçanta për lidhjen e kontratës

1. Kushtet esenciale (thelbësore) për lidhjen e kontratës.

B5 – Marrëdhëniet e veçanta të detyrimeve kontraktuese (llojet e kontratave)

1. Hyrje;
2. Karakteristikat e kontratave;
3. Llojet e kontratave;

B6 – Mospërmbushja (shkeljet) e kontratave

1. Shkeljet e kontratave;
2. Zgjidhja (ndërprerja) e kontratës;
3. Kuptimi dhe efektet e shkeljes së kontratës;
4. Kontratat e pavlefshme – nule;
5. Kontratat e rrëzueshme;
6. Zgjidhja ose revidimi i kontratave për shkak të ndryshimit të rrethanave;
7. Pamundësia e përmbushjes së kontratave;
8. Dëmtimi përtej mase;

B7 – Mjetet për mbrojtjen juridike të detyrimeve (shkeljes së kontratave)

1. Llojet e procedurës civile;
2. Parashtrirat;
3. Ushtrimi i mjeteve për mbrojtje juridike;
4. Padia – nocioni dhe përmbajtja;
5. Mjetet provuese dhe marrja e provave;
6. Vendimet gjyqësore;
7. Procedura në kontestet tregtare (ekonomike);
8. Procedura e gjykimit nga arbitrazhi;
9. Mjetet e zakonshme të goditjes;
10. Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes;
11. Procedura e përmbarimit;

B8 – Përfaqësimi sipas autorizimit dhe pakujdesia (neglizhenca) profesionale

1. Përfaqësimi i autorizuar në përgjithësi;
2. Pakujdesia (neglizhenca) profesionale;

PJESA “C” E DREJTA E PUNËS

C1 – Marrëdhëniet e punës

1. Kuptimi i të drejtës së punës;
2. Burimet e të drejtës së punës;
3. Marrëdhëniet e punës;
4. Ligji i Punës;
5. Kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës;

C2 – Kontrata e punës

1. Çka është kontrata e punës;
2. Forma e kontratës;
3. Përmbajtja e kontratës;
4. Të drejtat dhe detyrat e përcaktuara me kontratë;

C3 – Ndërprerja e marrëdhënies së punës

1. Kuptimi ligjor për ndërprerjen e marrëdhënies së punës;
2. Ndërprerja e marrëdhënies së punës;
3. Procedura para ndërprerjes së marrëdhënies së punës;
4. Procedura për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës;
5. Përgjegjësitë e të punësuarit;

C4 - Organizatat e të punësuarve dhe të punëdhënësve

1. Liria e organizimit sindikal- sindikatat;
2. Dialogu social;
3. Marrëveshja kolektive;
4. Oda Ekonomike e Kosovës;

C5 - Siguria dhe shëndeti në punë

1. Siguria në punë;
2. Detyrimet e punëdhënësit;
3. Detyrimet e të punësuarve;
4. Inspektorati i punës;
5. Sigurimi shëndetësor;

PJESA "D" Themelimi dhe Statusi i Shoqërive tregtare

D1 - Ligjet për shoqëritë tregtare

1. Ligjet për shoqëritë tregtare;
2. Ligji për tregtinë e brendshme;
3. Ligji për tregti me jashtë;

D2 - Ligji për shoqëritë tregtare;

1. Hyrje në Ligjin për Shoqëritë Tregtare

D3 - Regjistrimi i shoqërive tregtare/bizneseve

1. Agjencia për regjistrimin e bizneseve;
2. Regjistrimi i bizneseve;
3. Detyrat e Agjencisë për regjistrimin e bizneseve;

D4 - Biznesi Individual

1. Përgjegjësia ndaj Pronës

D5 - Ortakëria e Përgjithshme

1. Ortakët
2. Marrëveshja e ortakëve
3. Përgjegjësia ndaj pronës

D6 - Ortakëria e Kufizuar

1. Ortakët
2. Marrëveshja e ortakëve
3. Roli i ortakut të kufizuar
4. Përgjegjësia ndaj pronës

D7 - Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar

1. Pronarët
2. Kapitali
3. Qeverisja
4. Shpërbërja

D8 - Shoqëria Aksionare

1. Kapitali themeltar
2. Aksionarët
3. Qeverisja
4. Shpërbërja

Pjesa "E" - Bashkimi dhe Ndarja e Korporatave

E – Bashkimi dhe Ndarja e Korporatave

1. Bashkimi i SH.P.K. dhe SH.A
2. Ndarja e korporatave

E2 – Bashkimet Ndërkufitare të Korporatave

1. Marrëveshja për bashkim
2. Auditimi
3. Ndarja e korporatave

Pjesa “F” Pronësia Intelektuale dhe Partneriteti PP

F1 - Pronësia Intelektuale

1. Pronësia intelektuale;
2. Markat tregtare;
3. Të drejtat e autorit;
4. Patentat;
5. Dizajni industrial;

F2 – Partneriteti Publiko Privat

1. Partneriteti Publiko Privat (PPP);
2. Objekti i partneritetit publiko privat;
3. Parimet themelore dhe autorizimi për PPP;
4. Format e partneritetit publiko privat;

PJESA “G” - PAAFTËSIA PAGUESE E SHOQËRIVE TREGTARE (FALIMENTIMI)

G1 – Falimentimi i shoqërive tregtare

1. Hyrje;
2. Falimentimi;

G2 – Procedura gjyqësore e likuidimit

1. Likuidimi;
2. Lirimi nga borxhet

PJESA “H” – RAPORTIMI FINANCIAR I SHOQËRIVE TREGTARE

H1 – Raportimi financiar i shoqërive tregtare

1. Raportimi financiar;
2. Klasifikimi i shoqërive tregtare;
3. Standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar;
4. Këshilli i Kosovës për raportim financiar;
5. Certifikimi i kontabilistëve;
6. Licencimi i auditorëve;
7. Shoqatat profesionale;

PJESA “J” - SHKELJET LIGJORE PENALE

J1 – Përgjegjësia penale

1. Përgjegjësia penale;
2. Përgjegjësia penale e personave juridik;

J2 – Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal

1. Disa vepra penale të përgjithshme;
2. Veprat penale kundër ekonomisë;

J3 – Korrupsioni dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

1. Veprat penale korruptive;